



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

KESHILLI BASHKIAK BELSH

Nr Prot

Belsh më 29/02 / 2024

PROCES-VERBAL

I mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 29.02.2024 me 17 këshilltarë prezentë, në mbështetje të ligjit 139/2015 për vetëqeverisjen vendore. Njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar nëpërmjet formatit elektronik.

Janë prezent në mbledhje 17 këshilltarë:

1. Libeta Dragoti
2. Gezim Gjoshi
3. Bujar Blloku
4. Nexhip Elezi
5. Aurela Hysa
6. Erion Gjoshi
7. Sami Uruci
8. Kujtim Dervishi
9. Naime Ibrahimimi
10. Aurjola Bezati
11. Blerim Kujja
12. Nertila Uruci
13. Gazeli Hysa
14. Fadil Zdrava
15. Enkeleda Kullolli
16. Erjon Qafa
17. Ismail Paja

Hapet mbledhja e këshillit bashkiak nga kryetari i këshillit z.Kujtim Dervishi. Hidhet në miratim rendi i ditës dhe miratohet. Kalojmë te pika e parë e rendit të ditës për vërtetimin e mandatit të anëtarit të këshillit për z.Erjon Qafa. Lexohet formula e betimit nga kryetari i këshillit dhe betohet z.Erjon Qafa si këshilltar i këshillit bashkiak Belsh.

2.Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës,për miratimin e ndihmes ekonomike.Mbron Entela Dervishi,përgjegjëse e ndihmës ekonomike.

K. Dervishi: Hidhet në votim. Miratohet me 16 vota pro.

3. Diskutohet pika e 3-të e rendit të ditës për miratimin e kontratës midis IADSA dhe Bashkisë Belsh.Mbron Albert Hysa nga zyra e BE-së. Në mbledhje merr pjesë dhe kryetari i Bashkisë z.Arif Tafani.Diskutojnë këshilltarët Ismail Paja dhe Blerim Kuqja për sqarime të mëtejshme rreth kontratës.Diskutohet nga kryetari i Bashkisë që kulla aktuale në bashkëpunim me IADSA do të kthehet në një qendër informacioni dhe një muze i vogël në funksion të turizmit.

K.Dervishi: Hidhet për votim pika e 3-të ,miratohet me vota 15 pro dhe 2 kundër.

4. Kalohet në pikën 4 të rendit të ditës ,Për miratimin e komisioneve të këshillit të bashkisë.Diskutojnë kryetarët e grupeve për një marrëveshje.Propozohen komisionet me nga 3 veta.Hidhet në votim dhe **miratohet me 17 vota pro dhe asnjë kundër.**

5.Diskutohet pika e 5-të e rendit të ditës,Për miratimin e 2 pikave për vendosjen e 2 kioskave info point në administrimin e Green Belsh sh.a.Mbron administratori i Green Belsh z.Bledar Pepa. Propozon këshilltari Ismail Paja që të jetë vetëm një kioskë dhe jo 2 si në projekt.Hidhet në votim propozimi i këshilltarit Ismail Paja dhe nuk miratohet me shumicë votash.Propozon Nertila Uruci që të ketë orar më të kufizuar të parkingut me pagesë.Hidhet në votim propozimi dhe nuk miratohet me 3 vota pro dhe 14 kundër.
Hidhet në votim projekt vendimi dhe miratohet me 14 vota pro,1 abstenim dhe 2 kundër.

6.Diskutohet pika e 6-të e rendit të ditës, për miratimin e ndarjes së pasurive sipas planit të rilevimit.Mbron Anxhelina Liçi dhe Anxhela Dervishi.Këshilltari Ismail Paja pyet për sa vite jepen me qera pronat publike.Sqaron Kryetari i Bashkisë që jepen për 9.99 vjet ose më pak se 10 vjet.**Hidhet në votim Projekt vendimi dhe miratohet me 17 vota pro dhe asnjë kundër.**


7.Në mbledhje merr pjesë qytetari Flori Hysa ku kërkon hapje rrugë pas objektit që ka në pronësi,në territorin e shkollës 9-vjeçare Belsh dhe përkohësisht,me kusht që të rindërtojë me shpenzimet e veta murin e shkollës.**Hidhet në votim hapja e rrugës dhe miratohet me 17 vota pro.**

Mbyllet mbledhja e këshillit me 7 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri BEPA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE POLICIA BASHKIAKE IVMT
ZYRA E EMERGJENCAVE

Nr. 1108 Prot

Belsh, më: 18/03 2024

PROJEKT –VENDIM

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, vendimit nr. 1093 datë 18/12/2015 “Për miratimin e procedurave kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit” i ndryshuar, vendimit nr. 1093, datë 28/12/2015 “Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit” i ndryshuar, shkresës për fondet e kërkuara nga buxheti i shtetit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara në nenin 16, të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”.

PROPOZOJMË

- Sipas vkm 22/2018 per Strehimi Social ku buxheti i shteti mundeson pagesen e bonusit te qeras me vleren .6.090.000.00 nga Ministria e Finances si dhe vlera 2.610.00.0 nga bashkia Belsh ku vlera totale me bashkefinansim me bashkin Belsh per keto familje per 12 muaj eshte 8.700.000 leke ne total.

Pergjegjes i Strehimit Social : Ndricim QOSE 

Drejtori i EC,PB.IVMT :
Endri GJOSHI



KRYETARI
Arif TAPANI
(Në mungesë dhe me urdhër
Sekretarë përgjithshëm)
Mustafa ÇARÇI




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE POLICIA BASHKIAKE IVMT
ZYRA E EMERGJENCAVE

RELACION

Projekt vendimi ka si per synim shqyrtimin e familjeve te cilat sipas ligjit duhet te perlllogaritin vleren e bonusit te qeras ku nuk duhet te jete vlera mbi nr. e antarve te familjeve si dhe per meter katror te Njesis qe jeton. Niveli i qirasë sociale nuk duhet të jetë më i lartë se niveli mesatar i qirasë në tregun e lirë. Pagesa që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionimit të qirasë nuk duhet t'i kalojë 25 për qind të të ardhurave të familjes. Aftësinë e familjes për të përballuar pagesat mujore të qirasë, sipas përcaktimeve të nenit 3 të ligjit nr. 22/2018.

Kriteret e cdo familje e cila duhet te plotesoj per marrjen e Bonusit te Qeras 2023-2024 jane:

- a) individët me statusin e jetimit;
- b) personat me aftësi të kufizuara;
- c) të moshuarit;
- ç) prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë;
- d) invalidët e punës;
- dh) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- e) emigrantët e rikthyer;
- ë) punëtori emigrant;
- f) azilkërkuesit;
- g) familjet e komunitetit rom;
- gj) familjet e komunitetit egjiptian;
- h) Viktimat e dhunës në familje;
- j) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
- k) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor,
- l) të miturit, 14-18 vjeç, dhe të rinjtë, 18-21 vjeç, në konflikt me ligjin, kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë, sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më të mirë në shoqëri;
- ll) vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara;
- m) familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012.

Ku sipas VKM 22/2018 per strehimin Social ministria e finances sebashku me bashkin Belsh kerkon te financoj per 12 muaj e vitin 2024.

Piken 45, te nenit nr.2 te ligjit 22/2018 "Per strehimin social", i ndryshuar, mbi percaktimin e te ardhurave mesatare.

Nenin 3, te ligjit, mbi parimin e perballueshmerise se strehimi.

Shkresen nr.1969/1, date 23.10.2023 te INSTAT, për treguesit e konsumit (shpenzimet mesatare mujore për konsum) në nivel qarku, sipas madhësisë së familjes per vitin 2022. Ne vijim te dergimit te dhenave nga INSTAT për treguesit e konsumit (shpenzimet mesatare mujore për konsum) në nivel qarku, sipas madhësisë së familjes per vitin 2022,ku jan llogaritur edhe te dhenat per cdo familje aplikuese .

Pergjegjes i Strehimit Social : Ndricim QOSE



Drejtori i EC,PB,IVMT :
Endri GJOSHI



BASHKIA BELSH

P/Vendim

Nr. 114 dt: 19/03 /2024

“Për disa ndryshime në buxhetin e vitit 2024”

Në zbatim të ligjit nr.139 dt.17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 dt.27.04.2017 “Për Financat Vendore”, Drejtoria e Financës së Bashkisë Belsh i propozon Këshillit të Bashkisë si më poshtë :

TE MIRATOJE:

1. Ndryshimet në Buxhet si më poshtë:
 - a. Shpenzime për “Projekti me IADSA” për shumën 603,129 (gjashtëqind e tre mijë e njëqind e njëzet e nëntë) lekë.
2. Financimi te behet nga Buxheti i Bashkise për shumën 603,129 lekë si më poshtë:
 - a. Të përdoret fondi me shumën 603,129 (gjashtëqind e tre mijëe njëqind e njëzet e nëntë) lekë nga Objekti Shpenzime Paga për Administratën, miratuar me vendim këshilli nr.78 dt.29.12.2023 “Mbi miratimin e Buxhetit për vitit 2024” me shumën 30,000,000 leke.

TOTALI = 603,129 lekë

Drejtori Finances
Alban NIPOLLI



Kryetari i Bashkisë
Arit TAFANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE, TË ARDHURAVE VENDORE DHE ZYRËS NDIHMËS
EKONOMIKE

PROJEKT -VENDIM

Nr 128 DATE 19/03/ 2024

"Miratimin e Tavanëve të Ardhurave për Projekt Buxhetin 2025-2027"

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", ligjin nr.68/2017 dt.27/04/2017 "Për Financat Vendore", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit Buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027".

Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe të Ardhurave të Bashkisë Belsh i propozon Këshillit të Bashkisë Belsh si më poshtë:

1. Të miratojë Tavanet e të Ardhurave për Projekt Buxhetin 2025-2027, sipas tabelës dhe relacionit bashkangjitur.

Drejtori i Zyrës Juridike/IT
Anxhelina Qypi

Drejtori Finances
Alban NIPOLLI



Kryetari i Bashkisë
Arif TAFANI



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA BELSH

Nr ____ Prot

Belsh më ____ / 03 /2024

RELACION

"Mbi hartimin e dokumentit të planifikimit të të ardhurave për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".

Në zbatim të Udhezimit Nr 3 datë 28/02/2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027". Bashkia Belsh mori të gjitha masat për hartimin e Projekt Buxhetit 2025-2027, duke u bazuar në të gjitha kriteret e Përcaktuara nga udhezimi i mesiperme. Për hartimin e Projekt – Buxhetit 2025-2027 duhet të ngrihet sipas udhëzimit Nr. 3 grupi për menaxhimin strategjik(GMS) i cili duhet të zbatohet me korrektësi të gjitha kriteret dhe kërkesat që janë përcaktuar në këtë udhëzim, dhe afatet sipas programit të punës .

Duke u bazuar në udhëzimet e ardhura për këte qëllim Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të përcaktojë prioritetet kryesore për periudhën 2025-2027.

Gjatë hartimit të Projekt Buxhetit si për burimet financiare dhe shperndarjen e tyre janë mbajtur parasysh të gjitha burimet e mundshme financiare të vetë Bashkisë.

Në hartimin e burimeve financiare të Bashkisë Belsh janë mbajtur parasysh të gjitha udhëzimet dhe ligjet për taksat dhe tarifat tatimore.

Më poshtë po trajtojmë disa nga treguesit më kryesore të këtij parashikimi.

Të ardhurat e Bashkisë Belsh nga viti në vitë vijnë në rritje dhe sipas viteve paraqiten si mëposhtë.

Kështu të ardhurat deri në vitin 2027 parashikohen të rriten si mëposhtë:

Nr.	Emërtimi	Fakti 2022	Fakti 2023	Parashikim i 2024	Parashikimi I 2025	Parashikim I 2026	Parashikim I 2027
1	Të Ardhurat	74,132,663.3	64,744,672	101,000,000	102,981,035	103,829,870	104,091,355

Më poshtë do rendisim zerat e taksave që ndikojnë në rritjen e totalit të të ardhurave, ecuria paraqitet si më poshtë:



REPUBLIKA E SHOIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr.	Emertimi	Fakti 2022	Fakti 2023	Parashikim I 2024	Parashikimi I 2025	Parashikim I 2026	Parashikim I 2027
1.	Taksa e Ndërteses	15,655,954	8,945,680	17,500,000	17,675,000	17,850,000	18,025,000
2.	Taksa e tokës bujqesore	13,392,473	14,762,880	34,370,500	33,000,000	32,000,000	30,000,000
3.	Taksa për zënie e hapësirave publike	3,138,818	3,354,444	3,300,000	3,465,000	3,531,000	3,597,000
4.	Tarifë Ndriçimi rrugor	2,042,268	1,240,389	3,000,000	3,300,000	3,450,000	3,600,000
5.	Tarifë pastrimi	13,864,688	9,171,631	16,610,000	16,776,100	17,440,500	18,271,000

- ✓ Taksa e Nderteses është parashikuar në rritje për periudhen 2025-2027 duke marre si bazë jo vetëm totalin e arkëtueshme për vitin kalendarik por vjen si detyrim të një pjese të borxhit që është për të mbledhur për taksën e ndërtese për subjektet familjare dhe subjektet ekonomike.
- ✓ Taksa e tokës bujqesore për vitet (2025-2027) është parashikuar si e ardhur në renie duke eliminuar taksat e prapambetura si pasoi e mosofrimit të sherbimit si mase shtrenguese për qytetaret e Bashkis Belsh.
- ✓ Taksa e Zenies se hapësires publike për vitet 2025-2027 është parashikuar të kete një rritje, kjo si pasoje e projektit "Rilindja Urbane"ka sjelle shumë te mira për bizneset duke shfytëzuar me se miri hapësiren publike kjo përkthyer në te ardhura për Bashkinë Belsh, Rritja e kesaj takse përfshin jo vetem Vjeljen e Taksës e Hapësires Publike të sheshit "Ansambli" por edhe të hapësirave publike që zotëron Bashkia Belsh për qellime biznesi.
- ✓ Tarifën e Ndriçimit rrugor është parashikuar në rritje për vitet 2025-2027, kjo rritje përfshin nje pjese të borxhit nga subjektet familjare dhe subjektet ekonomike, gjithashtu përfshinë edhe realizimin e projektit "Ndriçimi rrugor me ndriçues solar" të disa fshatrave, kjo përkthyer në të ardhura për Bashkinë Belsh si pasoje e faturimit të detyrimit për familjaret dhe bizneset.
- ✓ Tarifa e pastrimit eshte parashikuar ne rritje per vitet 2025-2027 si pasoi e rritjes se cilesis se sherbimit te pastrimit per te gjithë qytetaret e Bashkis Belsh(*subjektet familjare dhe subjektet ekonomike*).



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA BELSH

Nr.	Emertimi	Fakti i 2022	Fakti i 2023	Parashikimi i 2024	Parashikim i 2025	Parashikim i 2026	Parashikim i 2027
1.	Taksë Tabele	171,690	238,955	230,000	253,000	264,500	276,000
2.	Tatim mbi te Ardhurat personale	6,448,274	8,269,665	6,500,000	8,400,000	8,774,000	9,350,000
3.	Tarifa për shërbime të tjera administrative	3,933,640	4,236,700	4,260,000	4,266,000	4,269,000	4,272,000

Nga shuma totale e të ardhurave ka ndikuar dhe një sërë taksash dhe tarifash të tjera, që përgjithësisht parashikohen një rritje e lehtë nga viti në vitë.

- ✓ Taksa e tabelës për vitet 2025-2027, është parashikuar në rritje kjo bazuar në kërkesen e subjektet ekonomike, për vendosje tabelle me qëllim reklamimi dhe orientimi.
- ✓ Tatim mbi te Ardhurat personale nisur nga fakti në rritje për vitet 2022, 2023, parashikohet një rritje për periudhën 2025-2027 si pasoi e mbajtjes së tatimit mbi te ardhurat personale.
- ✓ Tarifa për shërbime të tjera administrative është parashikuar në rritje për periudhën 2025-2027 nisur edhe nga fakti për vitet 2022-2023, etj.

Bashkangjiur këtij Relacioni është tabela me parashikimin e të ardhurave për periudhën 2025-2027 dhe program i punës me Grupin e Menaxhimit Strategjik(GMS)

P/Tatim-Taksave

Ditjon PEPA

Dr. Finances

Alban NIPOLLI

Kryetari I Bashkisë

Arif TAFANI



Nivisa e vetëqeveritjes Vendore		Kodi		Emertimi		Parashikimi për vitin 2025		Parashikimi për vitin 2026		Parashikimi për vitin 2027	
Nr	Emertimi i të Ardhurave Tarifore	Fakti i vitit 2022	Fakti i vitit 2023	Parashikimi i vitit 2024	Parashikimi për vitin 2025	Parashikimi për vitin 2026	Parashikimi për vitin 2027	Fakti i vitit 2022	Fakti i vitit 2023	Parashikimi i vitit 2024	Parashikimi për vitin 2025
I.	Të ardhura nga taksa	42,854,165.0	37,328,922.00	64,741,500.00	64,226,500.00	61,785,000.00	62,401,500.00	15,655,954.00	8,945,680.00	17,500,000.00	17,850,000.00
1	Taksa mbi Ndërtuesi	13,392,473.00	14,762,880.00	33,370,500.00	33,000,000.00	25,000.00	30,000,000.00	1,540,000.00	1,400,000.00	1,680,000.00	1,820,000.00
2	Taksa mbi tëken bujqësore	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3	Taksa e Pjetës në hotel	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	2,969,268.00	1,609,346.00	1,400,000.00	1,540,000.00	1,680,000.00	1,820,000.00	7,168,638.00	7,386,722.00	7,500,000.00	8,165,000.00
5	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
6	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
7	Taksa për zënimet e hapësirave publike	3,138,818.00	3,354,444.00	3,000,000.00	3,465,000.00	3,531,000.00	3,597,000.00	224,585.00	180,893.00	250,000.00	226,600.00
8	Taksa e tabelës	171,690.00	238,955.00	230,000.00	253,000.00	264,500.00	276,000.00	96,299.00	195,356.00	210,000.00	240,000.00
9	Taksa të përkohshme	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
10	Taksa e rremës monetare	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
11	Takse vendore për biznesin e vogël	22,215.00	118,750.00	20,000.00	20,200.00	20,400.00	20,600.00	224,400.00	222,200.00	224,400.00	226,600.00
12	Takse tnuall	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
13	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	96,299.00	195,356.00	210,000.00	220,000.00	230,000.00	240,000.00	96,299.00	195,356.00	210,000.00	240,000.00
14	Taksa e qelbërit	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
15	Të tjera	14,125.00	95,896.00	0.00	28,785,500.00	29,692,800.00	30,739,750.00	-	-	-	-
II.	Të ardhura nga tariffat	22,994,156.3	17,487,174.00	28,195,000.00	28,785,500.00	29,692,800.00	30,739,750.00	13,864,688.00	9,171,631.00	16,610,000.00	17,440,500.00
1	Tarifa për pastiram	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2	Tarifa për hapësira publike	134,000.00	140,750.00	145,000.00	159,500.00	172,500.00	180,000.00	134,000.00	140,750.00	145,000.00	180,000.00
3	Tarifa vendore për ujin	2,042,268.00	1,240,389.00	3,000,000.00	3,300,000.00	3,450,000.00	3,600,000.00	350,277.00	306,277.00	310,000.00	372,000.00
4	Tarifa ndërtimtarinjtë	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
5	Tarifa tabelë	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
6	Tarifa sjeibërmi	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
7	Tarifa për Reklamë	-	319,960.00	230,000.00	253,000.00	264,500.00	276,000.00	-	-	-	-
8	Tarifa për leje Transporti	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-	-	-	-
9	Tarifa për shërbime të tjera administrative	3,923,640.00	4,236,700.00	4,260,000.00	4,266,000.00	4,269,000.00	4,272,000.00	85,037.00	46,900.00	80,000.00	104,000.00
10	Tarifa për shërbime sociale (arsim parashkollor konvikte)	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-	-	-	-
11	Tarifa për shërbime sociale (arsim parashkollor konvikte)	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-	-	-	-
12	Sporte dhe kultiva	85,037.00	46,900.00	80,000.00	88,000.00	96,000.00	104,000.00	2,836,514.34	1,964,617.00	3,490,000.00	3,577,250.00
13	Tarife për vertetime	48,000.00	60,000.00	70,000.00	77,000.00	84,000.00	87,500.00	1,123,665.0	925,098.00	1,153,500.00	1,188,105.00
14	Tarifa të tjera nga MINZSH	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
15	Tarifa të tjera nga MINZSH	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
III.	Të ardhura nga shifra e pronës dhe detyra me qera	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
1	Shifra Ndërtuese	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-	-	-	-
2	Shifra Troje	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	-	-	-	-
3	Shifra të pronave të ndryshkëm	921,412.00	759,450.00	980,000.00	989,800.00	999,600.00	1,009,400.00	202,253.00	165,648.00	173,500.00	178,705.00
4	Qera Troje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Qera nga Ndërtuesi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
6	Indersa nga të ardhurat	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
IV.	Të ardhura nga tjetra	7,160,677.0	9,003,478.0	6,900,000.0	8,504,000.0	9,182,000.0	9,762,000.0	11,000.00	11,000.00	50,500.00	51,500.00
1	Të tjera Gjoka	388,325.00	11,000.00	80,000.00	50,500.00	357,000.00	360,500.00	42,4078.00	722,813.00	250,000.00	360,500.00
2	Kamavecoese	6,448,274.00	8,269,665.00	6,500,000.00	8,400,000.00	8,774,000.00	9,350,000.00	-	-	-	-
3	Tatimi mbi të ardhurat personale	741,327,663.3	647,446,720.00	101,000,000.0	102,981,035.0	103,829,570.0	104,001,355.0	-	-	-	-
TOTALI TË ARDHURAVE TË VETA											

Emri:
Nenshkrimi:
Data:

Drejtori i ngrunximit
te prognozeve

Sekretari i GJMS

Nepunuesi i Gjykatës





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE, TË ARDHURAVE VENDORE DHE ZYRËS NDIHMËS
EKONOMIKE

PROJEKT - VENDIM

Nr. 1127 DATE 18/03 2024

"Miratimin e Tavanëve të Shpenzimeve për Projekt Buxhetin 2025-2027"

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", ligjin nr.68/2017 dt.27/04/2017 "Për Financat Vendore", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.3 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit Buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027".

Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe të Ardhurave të Bashkisë Belsh i propozon Këshillit të Bashkisë Belsh si më poshtë:

1. Të miratojë Tavanet e Shpenzimeve për Projekt Buxhetin 2025-2027, sipas tabelës dhe relacionit bashkangjitur.

Drejtori i Zyrës Juridike/IT

Anxhelina Qypi

Drejtori Finances

Alban NIPOLLI

Kryetari i Bashkisë

Arif TAFANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr. ____ Prot

Belsh më: ____ . ____ . 2024

RELACION

“Mbi hartimin e dokumentit të planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 3 datë 28/02/2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”. Bashkia Belsh mori të gjitha masat për hartimin e Projekt Buxhetit 2025-2027 duke u bazuar në të gjitha kriteret e përcaktuara nga udhëzimi i mësipërm. Për hartimin e Projekt - Buxhetit 2025-2027 duhet të ngrihet sipas Udhëzimit Nr.3 grupi për menaxhimin strategjik (GMS) i cili duhet të zbatohet me korrektësi të gjitha kriteret dhe kërkesat që janë përcaktuar në këtë udhëzim, dhe afatet sipas programit të punës. Duke u bazuar në udhëzimet e ardhura për këtë qëllim Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të përcaktojë prioritetet kryesore për periudhën 2025-2027.

Gjatë hartimit të Projekt Buxhetit si për burimet financiare dhe shpërndarjen e tyre janë mbajtur parasysh të gjitha prioritetet më të domosdoshme për periudhën 2025-2027, duke evidentuar dhe planifikuar të gjitha burimet e mundshme financiare të vetë Bashkisë dhe burimet financiare të ardhura nga transfertat e kushtëzuar dhe e pakushtëzuar si fondet e tjera të ardhura nga fondi i zhvillimit rajonal, Akum etj. Gjatë hartimit të Projekt buxhetit janë bërë takime me grupet e interesit dhe komunitetin dhe të gjitha kërkesat dhe prioritetet e dala ju paraqiten Nënpunësit e Autorizuar. Në hartimin e burimeve financiare të Bashkisë Belsh janë mbajtur parasysh të gjitha udhëzimet dhe ligjet për taksat vendore dhe mbi këtë bazë janë parashikuar të ardhurat dhe shpenzimet. Ndërsa për transfertën e pakushtëzuar për çdo vit 2025-2027 është mbajtur parasysh kriteri i përcaktuar në udhëzimin nr.3 date 28.02.2024. Me poshtë po trajtojmë disa nga treguesit më kryesor të tavanëve:

Për sa i përket shpenzimeve për Projekt Buxhetin 2025-2027 janë bërë mbi bazën e të gjitha nevojave dhe prioritetet më të domosdoshme në përputhje me burimet financiare që ka në dispozicion Bashkia. Shpenzimet më të mëdha janë planifikuar në ato struktura buxhetore që janë më të rëndësishme dhe sidomos në investime.

Struktura e programeve të buxhetit vendor Belsh do të jete si me poshtë:

Nr	Funksioni	Nr	Nen/funksioni	Nr	Programi
1	PLANIFIKIMI, MANAXHIMI DHE ADMINISTRIM	011	Organet ekzekutive dhe legislative, çështjet financiare fiskale dhe çështjet e brendshme PAK dhe ndihma ekonomike	01110	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim Gjendje Civile PAK
		010		10430	
2	RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	031	Shërbime Policore	03140	Shërbimet e Policisë Vendore
		032	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
		010	Shërbimet e Emergjencës	10910	Emergjencat civile
3	MBESHTETJE PER ZHVILLIM EKONOMIK DHE MIRMBAJTJA E RRUGEVE	042	Ujta/Kullimi	04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe Kullimit
			Mirmbajtja e Rrugeve/Projektet	04520	Rrjeti Rrugor Rural
4	SHERBIMET PUBLIKE VENDORE DHE MBROJTJA E MJEDISIT	062	Sherbimet Publike	06260	Sherbime Utilitare ne dobi te Komunitetit
		042	Pyjet	04260	Menaxhimi dhe Mirmbajtja e Fondit Pyjor
5	ARSIMI KULTURA DHE SPORTI	091/ 092	Arsimi Baze dhe i Mesem	06180	Arsimi baze dhe i Mesem
		082	Kultura	08220	Aktivitetet e ndryshme kulturore artistike.

Persa i përket shpenzimeve për Projekt Buxhetin 2025-2027 janë bërë mbi bazën e të gjitha nevojave dhe prioriteteve me të domosdoshme në përputhje me burimet financiare që ka në dispozicion Bashkia. Shpenzimet më të mëdha janë planifikuar në ato struktura buxhetore që janë më të rëndësishme dhe sidomos në investime.

Totali i shpenzimeve sipas viteve paraqitet si më poshtë:

000/mijë lekë

Nr	EMERTIMI	2022	2023	2024	2025	2026	2027
I.	Tot.Shpenzimeve	846,334	1,145,579	514,429	478.826	490.871	503,265

Sic shikohet nga të dhënat e mësipërme për vitin 2024 shpenzimet janë bërë mbi bazën e planifikimit të të ardhurave të veta të Bashkisë, nga transferata dhe të ardhura të trashëguara nga viti 2023 dhe nga transferata të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara që gjenerohen nga Qeveria për vitin aktual. Ndersa Planifikimi afatmesëm i të ardhurave dhe Shpenzimeve për periudhën 2025-2027 është bërë mbi bazën e një niveli rritjeje prej 1% që na lejon udhezimi nr. 3 date 28.02.2024 për transferatën e pakushtëzuar sektoriale, parashikimin e të ardhurave afatmesme të bera nga sektori i taksave në Bashkinë Belsh dhe transferatën e pakushtëzuar që sjell qeveria për planifikimin afatmesëm .

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitet 2025-2027 paraqiten si më poshtë :

000/mijë lekë

Nr	EMERTIMI	2022	2023	2024	2025	2026	2027
L.	Shp. Page	151,951	167,551	171,883	191,380	197,413	199,151

Përqindja që zënë shpenzimet për pagat e ndaj totalit të shpenzimeve:

000/mijë lekë

Nr	EMERTIMI	2022	2023	2024	2025	2026	2027
L.	%Pagave+ sig.shoqerore	18%	15%	33%	40%	40.2%	39.6%

Sic është përmendur edhe më lartë në hartimin e Projekt Buxhetin 2025-2027 prioriteti kryesor kanë qenë shpenzimet për investime si me burimet financiare nga vete Bashkia dhe financimet nga donatorë të tjerë. Në këtë Projekt Buxhet tre prioritete kryesore janë Investimet në Ujitje dhe Kullim, arsim dhe Investimet në infrastrukturë, rrugët rurale.

Për investimet është planifikuar një fond i konsiderueshëm kështu për vitin 2025 janë planifikuar 19.7% te totalit te shpenzimeve, per vitin 2026 jane planifikuar 19.8 % te totalit te shpenzimeve dhe per vitin 2027 jane planifikuar 21% te totalit te shpenzimeve.

Këto ishin tavanet e planifikuar për të ardhurat dhe shpenzimet për PBA-së 2025-2027, me kërkesat dhe propozimet që do të bëhen nga anëtarët e këshillit do të përfshihen në PBA përfundimtare dhe brenda datës 1 Qershor do ti dërgohen Ministrisë së Financave do të bëhen përmirsimet e nevojshme dhe do te paraqiten në Këshillin Bashkiak për miratimin Përfundimtar të PBA-së 2025-2027.

Specialiste Finance

Dr/Financës

Kryetari

Ornela URUÇI

Alban NIPOLLI

Arif TAFANI





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA BELSH

Nr 1128 prot

Belsh më : 1303/2024

PROJEKT –VENDIM

**“PËR DHËNIEN NE PËRDORIM TE SIPËRFAQES SË CAKTUAR TË FONDIT
PYJOR/KULLOSOR PUBLIK NË PRONËSI TË BASHKISË BELSH”**

Bazuar në Ligjin Nr.139 date 17.12.2015 “*Per vetqeverisjen vendore*”, te ndryshuar, Ligjin Nr. 57/2020 “*Për Pyjet*”, Ligjin nr. 48/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “*Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor*”, të ndryshuar, VKM nr.433, date 08.06.2016, “*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-komunave/bashkive*”, Vendim nr. 559, datë 29.7.2022 “*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore*”, si dhe Vendimin nr. 888, datë 27.12.2022 “*Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre*”, Udhëzimit Nr. 1 datë 09.06.2016 “*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik*”, i ndryshuar, Raportin tekniko-ekonomik “*Raport mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim të një sipërfaqe të caktuar të fondit pyjor/kullor në pronësi të Bashkisë Belsh*”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtoria Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Mjedisit, Pronave Publike ju,

PROPOZIJMË:

1. Miratimin për dhënie në përdorim të pasurisë A pjese e pasurisë Nr. 185/1, ZK. 1146, me adresa e pasurisë, Belsh-Hysë, lloji i pasurisë Kullotë, me sipërfaqe 77 000 m² me certifikatë pronësie të lëshuar me date 06/11/2020 Nr. 21340 në pronësi të Bashkisë Belsh, “*Për ndertimin e panele diellore/fotovoltaike*”.
2. Miratimin për dhënie në përdorim të pasurisë A pjese e pasurisë Nr. 1/179, ZK.2237, lloji i pasurisë Kullotë, me sipërfaqe 162 050 m² me certifikatë pronësie të lëshuar me date 18.12.2023 në pronësi të Bashkisë Belsh, “*Për ndertimin e panele diellore/fotovoltaike*”.

3. Miratimin për dhënie në përdorim të pasurisë "C" pjesë e Çertifikates së pronësive me nr. Pasurie 42/3 zona kadastrale 1478 Fshati Dëshiran , Bashkia Belsh rezulton që sipërfaqja është 30ha, dhe shtrihet në ngastrat/nëngastra/26/a e cila sipas vkm 684 është me sipërfaqe totale 48.47 ha; bën/bëjnë pjesë në ekonominë pyjore/kullosore Dumrea janë ne pronesi/administrim të Bashkisë Belsh, "Për mbarëshkrimin e faunës së egër dhe gjahut".
4. Afati i dhënies në përdorim me qira të sipërfaqes do të jete 9 vjet, me të drejtë rinovimi të kontratës së qirasë sipas dispozitave ligjore në fuqi.
5. Efekti: Jep një impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, di dhe sigurohen të ardhura për bashkinë, që kthehen në investime publike.
6. Vlera vjetore e dhënies me qira do të jete sipas VKM-se nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", shtojca nr.1 pika 8, në afatin 6-10vjet.
7. Pas miratimit në Këshill dhe shprehja e ligjshmërisë nga ana e prefektit të qarkut, do të vazhdohet procedura për dhënie në përdorim të kësaj pasurie me anë të konkurimit publik duke bërë shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike sipas afateve ligjore, në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 01. datë 09.06.2016. për "Rregullat e procedurat e kërkitimit të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

Dr/Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve dhe Mjedisit

Ervis Shehu

P/Spektori i Pronave Publike

Anxhela Dervishi

Specialist i pyjeve dhe kullotave

Klodian Ganxhi

Dr.Ndihmës Juridike dhe IT

Anxhelina Qypi

KRYETARI I BASHKISË

Arif TAFANI

(Në mungesë dhe me urdhër)

Sekretari i Përgjithshëm

Mustafa ÇARÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA BELSH

Nr _____ prot

Belsh më: __ / __ / 2024

RELACION
“PËR DHËNIEN NE PËRDORIM TE SIPËRFAQES SË CAKTUAR TË FONDIT
PYJOR/KULLOSOR PUBLIK NË PRONËSI TË BASHKISË BELSH”

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Belsh

Të nderuar këshilltar!

Bashka Belsh në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilat është administrimi i fondit pyjor dhe kulloror ne territorin e Bashkisë Belsh, sipas legjislacionit ne fuqi. Pjesë e administrimit- menaxhimit është dhënia në përdorim/me qera e pasurive për ushtrimin e aktivitetesh të ndryshme nga persona fizik dhe subjekte konform legjislacionit të pyjeve e kullotave.

Baza ligjore:

- Ligjin Nr .139 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “
- Ligjin nr. 115/2014 dt. 31. 07.2014 “ Për Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në RSH ”,
- Ligjin Nr. 57/2020 “Për Pyjet”,
- Ligjit nr.9385, date 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar ,
- Ligji nr 8744 dt 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar,
- VKM nr.433,date 08.06.2016 ,“Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish-komunave/bashkive”,
- VKM nr, 684 date 02.09.2020 “ Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike”
- Vendim nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, bashkia ka për qëllim administrimin dhe rritjen e vleres se pronave publike .
- Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 01. datë 09.06.2016. për "*Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik*".

Sipërfaqjet qe propozohen te jepet ne përdorim jane :

- Dhenien në përdorim të pasurisë A pjesë e pasurisë Nr. 185/1, ZK. 1146, me adresa e pasurisë, Belsh-Hysë, lloji i pasurisë Kullotë, me sipërfaqe 77 000 m² me certifikatë pronësie të lëshuar me date 06/11/2020 Nr. 21340 në pronësi të Bashkisë Belsh, "Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)

Perdorimi i territorit	Sip. Ha	Bashkia	Volumi m ³	Vlera		Gjatesia Perd.km	Tarifa dhenie ne perdorim lek/ha/vit			ShumaII	TOTALII+I L
				lek/m ³	Shuma I		1	2 deri5	6 deri10		
0	12		3	4	5	6	7	8	9	10	11
Kullote	7.7	Belsh	0	0	0		1 478 400	1 416 800	1 355 200	0	0
Gjithesëj	7.7		0	0	0		1 478 400	1 416 800	1 355 200	0	0

- Dhenien në përdorim të pasurisë A pjesë e pasurisë Nr. 1/179, ZK.2237, lloji i pasurisë Kullotë, me sipërfaqe 162 050 m² me certifikatë pronësie të lëshuar me date 18.12.2023 në pronësi të Bashkisë Belsh, "Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)

Perdorimi i territorit	Sip. Ha	Bashkia	Volumi m ³	Vlera		Gjatesia Perd.km	Tarifa dhenie ne perdorim lek/ha/vit			ShumaII	TOTALII+I L
				lek/m ³	Shuma I		1	2 deri5	6 deri10		
0	12		3	4	5	6	7	8	9	10	11
Kullote	16.2	Belsh					3 110 400	2 980 800	2 851 200		
Gjithesëj							3 110 400	2 980 800	2 851 200		

- Dhenien në përdorim të pasurisë "C" pjesë e Çertifikates se pronesise me nr. Pasurie 42/3 zona kadastrale 1478 Fshati Dëshiran , Bashkia Belsh rezulton që sipërfaqja është 30ha, dhe shtrihet në ngastrat/nëngastra/26/a e cila sipas vkm 684 është me siperfaqe totale 48.47 ha; bën/bëjnë pjesë në ekonomitë pyjore/kullosore Dumrea jane ne pronesi/administrim te Bashkise Belsh, "Për mbarëshkrimin e faunës së egër dhe gjahut".

Perdorimi i territorit	Sip. Ha	Bashkia	Volumi m ³	Vlera		Gjatesia Perd.km	Tarifa dhenie ne perdorim lek/ha/vit			ShumaII	TOTALII+I L
				lek/m ³	Shuma I		1	2 deri5	6 deri10		
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
pylle	30	Belsh					720 000	690 000	600 000		
Gjithesëj							720 000	690 000	600 000		

Bazuar ne Vendimin nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

